

Hapet thirrja për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin e Humboldt-Universität zu Berlin, në Gjermani për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Humboldt-Universität zu Berlin, në Gjermani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

<https://www.hu-berlin.de/en/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të vitit të fundit për kërkim dhe shkrim të tezës;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Master;

-Doktoraturë;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimin e studentëve për kërkim dhe shkrim të tezës (3 muaj);

Fushat e studimit:

-Gjuhë dhe Linguistikë Gjermane;

-Shkenca kompjuterike, Histori, Shkenca Politike, etj., sipas linkut të mëposhtëm:

<https://www.hu-berlin.de/en/studies/counselling/course-catalogue>

KUJDES!

Për të aplikuar për shkrimin/kërkimin e tezës MA/Ph.D., studenti duhet të kontaktojë paraprakisht një profesor në universitetin pritës, për të marrë miratimin paraprak. Për kontakte klikoni linkun:

<https://www.hu-berlin.de/en/institutions/faculties-and-departments/standardseite>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 EUR në muaj);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Për më shumë informacion për procedurat e aplikimit referohuni linkut:

<https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide>

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

-CV (në gjuhën angleze/ gjermane, sipas programit të studimit ku po aplikoni);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);

- Dokumenti i aplikimit, të cilin mund ta shkarkoni në adresën:

https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide/forms-and-templates/01_KA107%20Application%20form%20SM%20ST%20INC%20OUT.pdf

- Dipolma e Bachelor;

- Listë notash bachelor (në gjuhën shqipe si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);

- Listë notash master (në gjuhën shqipe si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);

-Letër Motivimi (në gjuhën angleze/gjermane, sipas programit të studimit ku po aplikoni);

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Gjermanisht B1 dhe/ose Anglisht B2, sipas programit të studimit ku po aplikoni, ose në mungesë të saj plotësoni dokumentin Language Assessment Sheet). Për t'a shkarkuar këtë dokument vizitoni:

<https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide/forms-and-templates/Language%20Certificate.pdf>

-Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit. Ju mund të shkoni në universitetin pritës edhe për të bërë hulumtime dhe për të shkruar tezën tuaj të Masterit. Kini parasysh që teza mbrohet në UT.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide/forms-and-templates/04_01_KA%20107%20Learning%20Agreement%20SM%20INC%20OUT_NEW.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Doktoraturë**:

-CV (në gjuhën angleze/ gjermane, sipas programit të studimit ku po aplikoni);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);

- Dokumenti i aplikimit, të cilin mund ta shkarkoni në adresën:

https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide/forms-and-templates/01_KA107%20Application%20form%20SM%20ST%20INC%20OUT.pdf

- Diploma Bachelor;

- Listë notash bachelor (në shqip si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

- Diploma Master;
 - Listë notash bachelor (në gjuhën shqipe si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);
 - Listë notash master (në gjuhën shqipe si dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);
 - Letër Motivimi (në gjuhën angleze/gjermane, sipas programit të studimit ku po aplikoni);
 - Certifikatë e gjuhës së huaj (Gjermanisht B1 dhe/ose Anglisht B2, sipas programit të studimit ku po aplikoni, ose në mungesë të saj plotësoni dokumentin Language Assessment Sheet). Për t'a shkarkuar këtë dokument vizitoni:
- <https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide/forms-and-templates/Language%20Certificate.pdf>
- Përshkrim të projektit PhD dhe plan të punës për periudhën shkencore të studimeve;
 - Letër paraprake pranimi nga një supervizor në universitetin pritës;
 - Letër rekomandimi nga udhëheqësi i Doktoraturës në UT;
 - Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit. Ju mund të shkoni në universitetin pritës edhe për të bërë hulumtime dhe për të shkruar tezën tuaj të Ph.D.. Kini parasysh që teza mbrohet në UT.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://www.international.hu-berlin.de/en/studierende/aus-dem-ausland/erasmus-worldwide/forms-and-templates/04_01_KA%20107%20Learning%20Agreement%20SM%20INC%20OUT_NEW.pdf

Afati për aplikime: 08 Nëntor 2019

Dokumentat duhen dorzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në UT në adresën: iro@unitir.edu.al ose të vizitoni:

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!